

Arrestohet një serb në veri, i sekuestrohen “radiolidhje e pajisje ndihmëse për trazira”



Foto: Xhelal Sveçla

Njësia Antidrogë e Policisë së Kosovës ka bastisur të mërkurën një lokacion në fshatin Leshak të Leposaviqit.

Pas bastisjes, ka sekuestruar 4 granata dore, 12 mijë euro, 1 kallashnikov me 200 fishekë të ndryshëm, radiolidhje e pajisje të tjera ndihmëse për trazira.

Në njoftimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, u tha se është arrestuar një person i nacionalitetit serb, derisa dyshohet se këto pajisje janë pjesë e aktiviteteve ilegale dhe kriminale.

Sveçla shkroi se aksioni është duke vazhduar.

“Mbesim të përkushtuar maksimalisht që në koordinim me të gjitha institucionet e sigurisë të veprimë në zbatim të ligjit në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Pa asnjë dallim do të veprimë mbi çdo individ apo grup të caktuar që synon të cenojë rendin, ligjin dhe sigurinë e qytetareve dhe vendit tonë”, thuhet në njoftim.

26 tetor 2022, 19:47

Shpërndaje në



82-vjeçari serb jep 50 euro rryfëf, arrestohet në Prizren bashkë me një zyrtar

Vdes një 63-vjeçar në Prizren, u goditë nga kamioni teksa po lëvizte me biçikletë

Digjen disa baraka afër OKUK-së, s'ka të lënduar

7 vjet burgim pasi tentoi ta vriste ish-bashkëshorten, duke e thurur me thikë tetë herë

Kërkohet paraburgim ndaj dy të dyshuarve për mashtrim e falsifikim të dokumenteve

Policia hap rast për dy persona që ilegalaht kanë prerë dru në Malet e Sharrit

Krivaqa e Sejdlu deklarohen të pafajshëm: Aktakuza e prokurorit s'ka të bëjë me realitetin




© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Komento

#LEPOSAVIQ #LESHAK #XHELAL.SVECLA

TË TJERA



Rrahje mes nxënësve në Prishtinë, tre të lënduar



Arrestohet një 46-vjeçar në Ferizaj që dyshohet se sulmoi një grua



Aksidenti me fatalitet në Mazgit, këmbësori ishte goditur nga dy vetura



Të shtënat në Podujevë: Përleshje mes dy familjeve, pësuan kalimtarët